



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 407/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi, Kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli i parashtruar nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në tërë Komunën e Shtërpçës.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 07.11.2019 në ora 13:00, nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka(SLS), duke pretenduar se në Vendvotimin me nr. 2302D/01R në Komunën e Shtërpçës, në formularin e plotësuar nga KVV, kanë pasur 0 vota, ndërsa pas rinumërimit të votave nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) janë gjetur 21 vota për subjektin politik SLS.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i, që të rinumrohen votat e të gjitha Vendvotimeve në Komunën e Shtërpçës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit kërkon që të rinumërohen të gjitha kutitë e votimit në Komunën e Shtërpçës, sepse nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), e njëjta posedon 21 vota, ndërsa sipas Formularit për Rezultatet Përfundimtare të KQZ-së, posedon 0 vota, ku diferenca sipas parashtruesit të ankesës është 21 vota.

Mirëpo, pretendimet në apel me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se në cilat vendvotime iu janë bërë parregullsi, ashtu siç pretendon, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, apelin e parashtruar e konsideron si të përgjithshëm dhe të pa bazuar konform

dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit nuk ka ofruar asnjë dëshmi për t'i vërtetuar dyshimet e tij të pretenduara në apel edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e apelit, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë, të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.407/2019 më datën 08.11.2019

Kryesuesi i Panelit

Rrustem Thaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 1 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.